

# **L I G J**

**Nr.9090, datë 26.6.2003**

## **PËR NDËRMJETËSIMIN NË ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE**

Në mbështetje të neneve 78 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### **K U V E N D I**

### **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

### **V E N D O S I:**

#### **Neni 1**

1. Ndërmjetësimi është veprimtari jashtëgjyqësore, në të cilën palët kërkojnë ndërmjetësimin e një personi të tretë ose të një grupi personash, për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin.
2. Ndërmjetësuesi ose grupi i ndërmjetësuesve nuk ka të drejtë të urdhërojë ose të detyrojë palët të pranojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

#### **Neni 2**

1. Ndërmjetësimi, sipas këtij ligji, zbatohet për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës civile, tregtare, familjare dhe penale, që shqyrtohen nga gjykata, me kërkesën e të dëmtuarit akuzues ose ankimit të të dënuarit, sipas neneve 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale.
2. Ndërmjetësimi, sipas këtij ligji, zbatohet në rastet kur kërkohet dhe pranohet nga palët, përpara ose pasi të ketë lindur mosmarrëveshja, kur është i detyrueshëm sipas ligjit, si dhe kur kërkohet ose çmohet nga gjykata, arbitrazhi ose organi përkatës shtetëror sipas ligjit.
3. Mosmarrëveshjet për të cilat është e detyrueshme zgjidhja në rrugë gjyqësore, nuk mund të zgjidhen me ndërmjetësim.
4. Për çështjet që lidhen me procedura, që nuk rregullohen nga ky ligj, në veprimtarinë e ndërmjetësimin, për aq sa është e mundur, zbatohen dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë parasysh natyrën ligjore të çështjes.

### **Neni 3**

Veprimtaria e ndërmjetësimit, sipas këtij ligji, mund të ushtrohet nga çdo person që përmbush këto kushte:

- a) ka mbushur moshën 22 vjeç;
- b) ka arsim të lartë;
- c) nuk është dënuar për vepra penale me dashje;
- ç) ka figurë morale dhe publike të përshtatshme për veprimtarinë e ndërmjetësimit.

### **Neni 4**

1. Ndërmjetësuesi e ushtron veprimtarinë si person fizik ose juridik nëpërmjet zyrës ose qendrës së tij.

2. Ndërmjetësuesit, që e ushtrojnë këtë veprimtari si profesion, përpara fillimit të veprimtarisë janë të detyruar të regjistrohen në gjykatë si persona fizikë a juridikë, të depozitojnë të dhënat e tyre në regjistrin e ndërmjetësuesve pranë Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në organet tatimore, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Ndërmjetësuesit, kur ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit si profesion, organizohen kolektivisht për vendosjen dhe respektimin e rregullave profesionale dhe etike, të detyrueshme për t'u zbatuar gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie.

4. Ndërmjetësuesit, që e ushtrojnë këtë veprimtari si profesion, kanë të drejtë të kërkojnë dhe të shpërblehen për punën, si dhe për shpenzimet e kryera në procedurën e ndërmjetësimit, sipas marrëveshjes për ndërmjetësim, të nënshkruar me palët.

### **Neni 5**

1. Procedura për ndërmjetësim, përveçse kur palët bien dakord ndryshe, fillon në datën kur palët janë marrë vesh për të ndjekur procedurat e ndërmjetësimit, sipas këtij ligji.

2. Nëse një palë në mosmarrëveshje i kërkon një palë tjetër ndjekjen e procedurave të ndërmjetësimit, sipas këtij ligji, dhe kjo e fundit nuk i përgjigjet kësaj kërkesë brenda 30 ditëve nga data në të cilën është dërguar ftesa ose brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesë, pala kërkuese mund ta vlerësojë këtë si mospranim të ftesës për të ndërmjetësuar.

### **Neni 6**

Në ndërmjetësimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes caktohet një ndërmjetësues, përveç rastit kur palët nuk vendosin me marrëveshje për një grup ndërmjetësuesish.

## **Neni 7**

1. Në procedurën e ndërmjetësimit me një ndërmjetësues, palët merren vesh për caktimin e ndërmjetësuesit të vetëm.
2. Në procedurën e ndërmjetësimit me dy ndërmjetësues, secila palë cakton një ndërmjetësues.
3. Në procedurën e ndërmjetësimit me tre ose më shumë ndërmjetësues, secila palë cakton një ndërmjetësues dhe së bashku merren vesh për caktimin e ndërmjetësuesve të tjerë.
4. Palët, për caktimin e ndërmjetësuesit, mund të kërkojnë këshillimin ose mbështetjen e një personi fizik ose juridik, të njohur për veprimtari në fushën e ndërmjetësimeve dhe, në veçanti, për këto çështje:
  - a) për t'i rekomanduar emrat e personave të përshtatshëm si ndërmjetësues;
  - b) për t'i caktuar një ose më shumë persona të përshtatshëm si ndërmjetësues.
5. Në rekomandimin ose caktimin e ndërmjetësuesve, institucioni ose personi i ngarkuar duhet t'i përmbahet detyrimit për të siguruar një ndërmjetësues të pavarur dhe të paanshëm.
6. Kur një personi i ofrohet mundësia për t'u zgjedhur si ndërmjetësues, ai duhet të deklarojë çdo rrethanë që mund të dëmtojë ose shkaktojë dyshime për paanshmërinë dhe pavarësinë e tij. Ndërmjetësuesi, duke filluar nga koha e caktimit në këtë detyrë dhe gjatë kohës së procedurës së ndërmjetësimit, duhet t'u deklarojë pa vonesë palëve çdo rrethanë që mund të përbëjë cenim ose dyshim në paanshmërinë dhe pavarësinë e tij.

## **Neni 8**

1. Palët, në përputhje me këtë ligj, janë të lira të vendosin rregullat dhe mënyrën e zhvillimit të ndërmjetësimit.
2. Në mungesë të një marrëveshjeje për mënyrën e zhvillimit të ndërmjetësimit, ndërmjetësuesi ose grupi i ndërmjetësuesve mund ta zhvillojnë ndërmjetësimin në mënyrën më të përshtatshme për palët, mbështetur në rrethanat e çështjes, në çdo kërkesë që mund të paraqesin palët dhe në çdo nevojë për një zgjidhje të shpejtë të mosmarrëveshjes.
3. Në çdo rast, në zbatimin e procedurave të ndërmjetësimit, ndërmjetësuesi ose grupi i ndërmjetësuesve duhet të kujdesen për të siguruar trajtimin e njëjtë të palëve, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes.

4. Nëse nuk vendoset ndryshe nga palët, ndërmjetësuesi ka të drejtë që, në çdo fazë të zbatimit të procedurave të ndërmjetësimit, të propozojë një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes.

### **Neni 9**

Përveç rastit kur vendoset ndryshe nga palët, ndërmjetësuesi, grupi i ndërmjetësuesve ose një anëtar i këtij grupi mund të takojë ose të komunikojë me palët, së bashku ose veçmas me secilin prej tyre.

### **Neni 10**

Ndërmjetësuesi, grupi i ndërmjetësuesve ose një anëtar i këtij grupi, pasi njihet me rrethanat dhe të dhënat e ofruara nga njëra palë në mosmarrëveshje, mund t'i parashtrijë palës tjetër çështjet thelbësore që rezultojnë nga këto rrethana dhe të dhëna.

### **Neni 11**

1. Përveç rastit kur palët kanë rënë dakord ndryshe, tërësia e të dhënave dhe e rrethanave për procedurat e ndërmjetësimit duhet të mbeten konfidenciale.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet nëse njohja me të dhënat dhe rrethanat e ndërmjetësimit kërkohen nga ligji ose për qëllimet e zbatimit a të ekzekutimit të marrëveshjes së arritur në përfundim të procedurës së ndërmjetësimit.

### **Neni 12**

1. Përveç rastit kur palët kanë rënë dakord ndryshe, një palë që merr pjesë në procedurën e ndërmjetësimit ose një person i tretë, duke përfshirë edhe ndërmjetësuesin, nuk mund të kërkojnë ose të përdorin në një proces gjyqësor, arbitrazhi ose në ndonjë procedurë tjetër të ngjashme, prova ose dëshmi, pavarësisht nga forma e tyre, në rastet e mëposhtme:

a) ftesën e një pale për të marrë pjesë në një procedurë ndërmjetësimi ose veprimin me të cilin njëra nga palët ka shprehur vullnetin për të marrë pjesë në procedurën e ndërmjetësimit;

b) mendimet e shprehura ose sugjerimet e bëra nga njëra palë gjatë ndërmjetësimit ose nga ndërmjetësuesi për zgjidhjen e mundshme të mosmarrëveshjes;

c) deklaratat ose pohimet e bëra nga njëra palë gjatë zhvillimit të procedurës së ndërmjetësimit;

ç) propozimet e bëra nga ndërmjetësuesi;

d) faktin që njëra nga palët në procedurën e ndërmjetësimit ka shprehur vullnetin për të pranuar propozimin e bërë nga ndërmjetësuesi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes;

dh) një dokument të përgatitur vetëm për qëllim të procedurës së ndërmjetësimit.

2. Përveç rastit kur parashikohet nga ligji, në masën dhe mënyrën e caktuar prej tij, si dhe për qëllime të zbatimit ose ekzekutimit të një marrëveshjeje për ndërmjetësim ose të arritur në përfundim të kësaj procedure, gjykata, arbitrazhi ose autoritetet e tjera përgjegjëse nuk kanë të drejtë të urdhërojnë ose të pranojnë si provë të dhënat dhe rrethanat e paraqitura në pikën 1 të këtij neni. Këto të dhëna, nëse janë parashtruar ose pranuar prej tyre, janë të pavlefshme.

3. Rregullat e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni zbatohen nga gjykata, arbitrazhi dhe në procedura të tjera të ngjashme, pavarësisht nëse këto organe e shqyrtojnë një mosmarrëveshje që ka qenë ose është në procedurën e ndërmjetësimit.

4. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, provat që janë të pranueshme në një procedurë gjyqësore ose arbitrazhi janë të vlefshme edhe pse janë përdorur në një procedurë ndërmjetësimi.

### **Neni 13**

Procedura e ndërmjetësimit përfundon ditën e nënshkrimit:

a) të marrëveshjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjes;

b) të deklaratës me shkrim të ndërmjetësuesit ose të grupit të ndërmjetësuesve, pas këshillimit me palët që ndërmjetësohen, sepse përpjekjet për ndërmjetësim të mëtijshëm nuk janë të justifikuara;

c) të deklaratës me shkrim të palëve ndërmjetësuese, me anë të së cilës i drejtohen ndërmjetësuesit ose grupit të ndërmjetësuesve, ku i njoftojnë se procedura e ndërmjetësimit ka përfunduar;

ç) të deklaratës me shkrim të njëres palë, drejtuar palës tjetër, ndërmjetësuesit ose grupit të ndërmjetësuesve, ku njoftohen se procedura e ndërmjetësimit ka përfunduar.

### **Neni 14**

Nëse palët bien dakord për zgjidhjen e pranueshme të mosmarrëveshjes ndërmjet tyre dhe, së bashku me ndërmjetësuesit ose grupin e ndërmjetësuesve, nënshkruajnë marrëveshjen përkatëse, në kuptim dhe zbatim të kushteve, rasteve dhe procedurave të parashikuara në këtë ligj, kjo marrëveshje është e detyrueshme dhe e ekzekutueshme në të njëjtën shkallë me vendimet e arbitrazhit.

### **Neni 15**

Përveç rastit kur palët kanë rënë dakord ndryshe, ndërmjetësuesi nuk duhet të veprojë si arbitër për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje që ka qenë ose është subjekt i procedurave

të ndërmjetësimit ose për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje tjetër, që rrjedh nga e njëjta marrëdhënie, e cila i është nënshtruar procedurës së ndërmjetësimit.

## **Neni 16**

1. Gjykata ose arbitrazhi nuk fillon ose pezullon vazhdimin e procedurave përkatëse, në rast se palët në një mosmarrëveshje, subjekt gjykimi, kanë rënë dakord paraprakisht që të përdorin ndërmjetësimin për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje dhe, shprehimisht, kanë marrë përsipër që brenda një afati të caktuar ose deri në vërtetimin e një rrethane të caktuar, të mos kërkojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga gjykata ose arbitrazhi.

2. Pavarësisht nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni, njëra nga palët mund të kërkojë fillimin ose vazhdimin e gjykimit të çështjes në gjykatë ose në arbitrazh, kur çmon se në këtë mënyrë mbron të drejtat e veta. Fillimi i zbatimit të këtyre procedurave nuk shfuqizon marrëveshjen për ndërmjetësim ose mundësinë e zgjidhjes me ndërmjetësim të mosmarrëveshjes përkatëse.

## **Neni 17**

1. Ndërmjetësuesi, brenda 45 ditëve nga data që i është dërguar çështja nga gjykata ose prokuroria, i njofton ato për zgjidhjen ose jo të mosmarrëveshjes, duke dërguar edhe aktet përkatëse.

2. Në rastin kur është zgjidhur çështja me anë të ndërmjetësimit, organet gjyqësore e të prokurorisë vendosin pushimin e çështjes penale a civile ose refuzimin e fillimit të procedimit penal, si dhe bëjnë shënimet në regjistrat përkatës, përveç rasteve kur arrihet në përfundimin se vërehet pavlefshmëri.

3. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim, ku parashikohen detyrime në të holla, dorëzim sendesh ose kryerja e shërbimeve të vlerësueshme e të dokumentuara me shkrim, mund të kundërshtohet brenda 10 ditëve nga palët, pjesëmarrësit e tjerë në proces, personat e interesuar ose organi përkatës. Në të kundërt aktmarrëveshja përbën titull ekzekutiv në mbështetje të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile dhe ngarkohet Zyra e Përmbartimit për ekzekutimin e tij.

4. Kur bëhet kundërshtim, gjykata ose prokuroria marrin parasysh mënyrën e zgjidhjes me ndërmjetësim, por, gjithashtu, nuk ka pengesë ligjore për zgjidhje tjetër, në përputhje me ligjin.

## **Neni 18**

Gjykata ose prokuroria mund ta vlerësojë marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim të pavlefshme, kur arrin në përfundimin se nuk pasqyrohet vullneti i palëve në konflikt, kur janë cenuar rëndë të drejtat dhe interesat e tyre ose kur zhdëmtimi është haptazi në disproporcion me dëmin e shkaktuar.

## **Neni 19**

1. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim, në kuptim të këtij ligji, është e pavlefshme në rastet kur:

a) realizohet nga persona, që nuk janë ndërmjetës ose nuk duhet të jenë të tillë sipas këtij ligji;

b) mosmarrëveshja, sipas ligjit, duhet zgjidhur vetëm në rrugë gjyqësore;

c) përmban detyrime të vlerësueshme në të holla dhe nuk formulohet me shkrim;

ç) përmban detyrime për subjekte, që nuk kanë marrë pjesë në ndërmjetësim;

d) ka simulim dhe, për konfliktin real, ka shkaqe pavlefshmërie.

2. Pavlefshmëria e marrëveshjes së ndërmjetësimit, sipas këtij ligji, nuk i pengon palët në konflikt të realizojnë marrëveshjen e arritur, duke ushtruar të drejtat, që gëzojnë me ligje të tjera.

## **Neni 20**

Ligji nr.8465, datë 11.3.1999 "Për ndërmjetësimin për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve", shfuqizohet.

## **Neni 21**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3896, datë 17.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

Alfred Moisiu